



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCËVE CIVILE

Nr. 1464 Prot.

Patos më 15.05 /2025

MIRATOHET
KRYETARI
Faton Dura

PROJEKT-VENDIM

Nr. 20, datë 15.05.2025

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT
TË SHTETIT PËR VITIN 2025 PËR MBROJTJEN CIVILE PËR REHABILITIMIN
E PËRROIT NË LAGJEN E RE, FAZA II-TË DHE PËRROIT DUKAS**

Në mbështetje ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”, VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, Ekipi i programit të menaxhimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe mbrojtjes civile,

KËRKON:

1. Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2025 për mbrojtjen civile për **“Rehabilitimin e përroit në lagjen e Re, Faza II-të dhe Përroit Dukas (Blerje bazë materiale)”**, me vlerë **5,000,000 lekë** sipas kodit të produktit **91707 AG** “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme”.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile

Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**

Alket **HALIMI**

ANËTARËT

Arlind **RUSTO**

Florian **TORO**

Arben **SHPËRDHEJA**

Juriste

Nurkë **HAZIJAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS

Nr. 1464 Prot.

Patos më, 15/05/2025

RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË
BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2025 PËR MBROJTJEN CIVILE PËR
REHABILITIMIN E PËRROIT NË LAGJEN E RE, FAZA II-TË DHE
PËRROIT DUKAS**

Bashkia Patos në kuadër të menaxhimit të zonave problematike me qëllim shmangien e fatkeqësive natyrore ka ndërhyrë për rehabilitimin e përroit në lagjen e Re. Në fazën e parë të ndërhyrjes është trajtuar një segment me gjatësi rreth 430 ml i përroit. Punimet e realizuara nga Agjencia e Shërbimeve Publike kanë përfshirë pastrimin e shtratit të përroit nga të gjitha inertet e grumbulluara prej vitesh, riseksionimin dhe veshjen me shtresat përkatëse duke kthyer në normalitet rrjedhjen e ujërave dhe shmangien e problematikave si rezultat i përmytjeve në zonë përgjatë ditëve me reshje të dendura. Aktualisht e gjithë zona i është nënshtruar rikonstruksionit total të rrugëve dhe trotuareve duke i'u ofruar banorëve të asaj lagje shërbimet e munguara prej vitesh.

Ekipi i menaxhimit të mbrojtjes civile duke parë situatën në të cilën ndodhet pozicioni i përroit në lagjen "e Re" dhe përroit Dukasit të cilët grumbullojnë në shtratin e tyre ujërat e një sipërfaqeje të konsiderueshme duke përfshirë disa lagje dhe fshatra, sjellin probleme në kalueshmërinë e rrugëve kryesore në këto zona. Me qëllim rehabilitimin e përroit të lagjes së re përgjatë gjithë gjurmës së tij në territorin e bashkisë Patos, do të ndërhyhet në pjesën e mbetur të pa trajtuar në fazën e parë të punimeve. Faza e dytë do të përfshijë një segment me gjatësi rreth 150 ml dhe trajtimin e tij me qëllim krijimin e një rrjedhje të vazhduar, e cila shmang grumbullimin e inerteve apo krijimin e bimësisë të cilat krijojnë mundësinë për përmytje në zonë. Për përroitin e Dukasit i cili nuk është trajtuar më parë do të ndërhyhet fillimisht në një segment prej 150 ml duke pastruar dhe veshur me shtresat përkatëse seksionin e kanalit.

Ky projekt synon të reduktojë rrezikun e përmytjeve dhe të sigurojë mbrojtje të plotë të zonës dhe banesave përreth duke normalizuar rrjedhjen e ujit.

Fondi me vlerë 5,000,000 (pesë milion) lekë do të investohet për realizimin e këtij projekti.

Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për vitin 2025 për mbrojtjen civile në totalin e vet për Bashkinë Patos ka vlerën **5,045,349.60** (pesë milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë e dy pikë dyzetë e një) lekë. Me shkresën nr. 617/1 prot., datë 28/02/2025 drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, AKMC-së, Bashkia Patos ka bërë ndarjen si më poshtë:

1. Kodi i produktit 91707 AG “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese” në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerzve do të jetë: 5,000,000 (pesë milion) lekë.
2. Kodi i produktit 91707 AB “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” është 45,349.60 (dyzetë e pesë mijë e treqind e dyzetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë) lekë.

Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2025 për mbrojtjen civile për **“Rehabilitimin e përroit në lagjen e Re, Faza II-të dhe Përroit Dukas (Blerje bazë materiale)”**, me vlerë **5,000,000 lekë** sipas kodit të produktit **91707 AG “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme”**.
2. Për ndjekjen e zbatimit e projekt vendimit ngarkohet Drejtoria e Projekteve dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Shërbimeve.

Bashkëlidhur gjendet dhe preventivi i punimeve për rehabilitimin e përroit, faza dytë.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile

Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**

Alket **HALIMI**

ANËTARËT

Arben **SHPËRDHEJA**

Arlind **RUSTO**

Florian **TORO**

KRYETARI

Fation Duro